



**ZYRA E BANKES BOTERORE, Tiranë**

### **Thirrje për Projekte në kuadrin e Programit të Granteve të Vogla 2007**

Programi i Granteve të Vogla mundëson Bankën Botërore të promovojë dialogun dhe shpërndarjen e informacionit mes organizatave jofitimprurëse. Objektivi i Granteve të Vogla për vitin 2007 përqëndrohet në **angazhimin qytetar të të rinjve**.

Zyra e Bankës Botërore në Tiranë ju fton të paraqisni projekte që:

- Nxisin një pjesëmarrje më të madhe të të rinjve në diskutime dhe aktivitete në nivel kombëtar dhe lokal mbi çështje që lidhen me politikën rinore, arsimin, mirëqeverisjen, transparencën publike, migrimin e trurit, mbrojtjen e mjedisit, vlerave kulturore, etj.;
- I japin zë grupeve të të rinjve dhe ndihmojnë që nevojat dhe shqetësimet e tyre janë përfshirë në formulimin e politikave dhe programeve;
- Fuqizojnë grupet e përjashtuara dhe në nevojë të të rinjve për të ushtruar të drejtën publike për informacion;
- Nxisin bashkëpunimin rajonal të të rinjve për angazhimin qytetar të të rinjve si dhe aktivitete për shkëmbimin e eksperiencave e njohurive;
- Rishikojnë kuadrin ligjor mbi angazhimin qytetar dhe çështje të të rinjve.

Janë të ftuar të aplikojnë në këtë program organizata vendase të shoqërisë civile me një eksperience prej të paktën dy vjetësh. Shuma e financuar do të jetë midis 3000\$ dhe 7000\$. Të interesuarit mund të paraqiten për të tërhequr format e aplikimit dhe informacione të tjera mbi kriteret e aplikimit pranë Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë. Informacion është vendosur edhe në faqen e internetit: [www.worldbank.org.al](http://www.worldbank.org.al).

Forma e aplikimit dhe dokumentat e tjera të nevojshme duhet të dorëzohen në një zarf pranë Zyrës së Bankës Botërore në adresë të Koordinatorit të Programit të Granteve të Vogla, ose mund të dërgohen me e-mail në adresën [picalbania@worldbank.org](mailto:picalbania@worldbank.org) jo më vonë se 11 mars 2007.

**Adresa:**

**Koordinatori i Programit të Granteve të Vogla**

**Banka Botërore**

**Rruga “Dëshmorët e 4 shkurtit”, Nr. 34**

**Tel: 04 280 650/51**

**Fax: 042 405 90**

**Tiranë**